




KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE D.D.

PRISHTINA





Raporti tre-mujor TM3 i KRU “Prishtina” Sh.A., për vitin 2020

Vendimi: (VI-03)

Bordi i përkohshëm i Drejtorëve të KRU “Prishtina” sh.a., i emëruar sipas Vendimit të Qeverisë nr.02/19, të datës 03.08.2020, në mbledhjen e VI-të të rregullt të mbajtur me datë 07.12.2020 pas shqyrtimit të Raportit TM3 për muajt: Korrik, Gusht dhe Shtator 2020 të KRU “Prishtina” sh.a., njëzëri aprovoj raportin tre-mujor (TM3).

Njëkohesisht BpD inkurajoj menaxhmentin që të vazhdojë me përkushtimin për ngritje të performancës së përgjithshme dhe se i njëjti raport të dorëzohet në NJPMNP.

	Delegoj	Aprovoj
Emri dhe mbiemri:	U.D./Kryeshef Ekzekutiv z.Sokol Xhafa	Kryesues i BpD-së z.Labinot Dedushi
Nënshkrimi:		
Data:	07.12.2020	07.12.2020





KOMPANIA UJESJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE D.D.

PRISHTINA

PRISHTINA

RAPORT MUJOR 09/2020

TM - 3

PËRMBUSHJA E PËRGJEGJËSIVE NGA NENI 31 I LIGJIT
MBI NP-të PËR – TM3

ENGLISH

Përmbatja

PËRFORMANCA E PËRGJITHSHME	3
SHËRBIMET, FINANCAT, CENUESHMËRIA DHE EFEKTET SOCIO-EKONOMIKE NGA NDIKIMI I COVID 19 NË KRU “PRISHTINA”SH,A	3
I. Analiza e pasqyrave financiare: Përdoruesit e treguesve financiarë	8
1. Kompania Ujësjiellësi Rajonal "Prishtina" sh,a - Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare 09/2020	9
2. Kompania Ujësjiellësi Rajonal "Prishtina" sh,a - Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave gjithëpërfshirëse 09/2020	11
3. Kompania Ujësjiellësi Rajonal "Prishtina" sh,a - Pasqyra e konsoliduar e rrjedhjes së parasë 09/2020	12
4. Kompania Ujësjiellësi Rajonal "Prishtina" sh,a - Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në ekuitet.....	14
5.Raporti I performancës - Bazuar në muajt e vitit 2020	15
5.1 Indikatoret Kryesor Financiar - 2020 nga aspekti I të Hyrave, Inkasimeve dhe Shpenzimeve	16
6.Rrjedha e parasë nga aspekti I shpenzimeve të grumbulluara në kategori sipas muajve per vitin 2020	25
7. Raporti nga departamenti i shitjes	26
8. Raporti nga departamenti për Konsumatorë	28
9. Departamentet në Sekretarin e Ndërmarrjes.....	31
10. Raporti nga Departamenti i Administratës dhe Personelit.....	32
11. DEPARTAMENTET NEN DREJTORIN TEKNIK.....	33
12. RAPORTI NGA DEPARTAMENTI I PRODHIMIT	33
13. RAPORTI NGA SHËRBIMI I KUALITETIT TE UJIT	35
14. RAPORTI NGA DEPARTAMENTI I MIRËMBAJTJES.....	37
15. DEPARTAMENTI I MIRËMBAJTJES DHE TRAJTIMIN E UJËRAVE TE NDOTURA.....	39
16. DEPARTAMENTI I HUMBJEVE.....	41
17. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT	42

PËRFORMANCA E PËRGJITHSHME

SHËRBIMET, FINANCAT, CENUESHMËRIA DHE EFEKTET SOCIO-EKONOMIKE NGA NDIKIMI I COVID-19 NË KRU "PRISHTINA"SH,A

Menagjmenti i KUR "Prishtina" sh.a. i përkrahur nga palët e interesit (Bordi i Drejtorëve- aksionari,ARRU, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit si aksionari i ndermarrjeve publike,donatorët,institucionet financiare-kreditdhënëse, konsumatorët etj) dhe me ndihmën e të gjithë punëmarrësve kemi motiv furnizimin cilësor dhe sasior me ujë të pijes dhe largimin e ujërave të ndotura.

Qëllimi i këtij raporti është që të paraqes ndikimin e pandemisë COVID-19 në buxhetin e KRU "Prishtina"sh,a, por edhe mundësitë dhe rreziqet që përmes granteve të ndryshme të bëhet rimëkëmbja ekonomike dhe sociale e shkaktuar nga kjo pandemi.

Ofrimi i shërbimeve kualitative dhe rritja e qëndrueshmërisë financiare është synimi i së tashmes dhe i së ardhmes së kompanisë.

Të vetëdijshëm se në kushtet e tanishme e sidomos gjatë kohës prej kur është shfaqur Pandemia në vendin tone e ka bërë të pamundur arritjen e objektivave të synuara nga Bordi dhe menaxhmenti i ndermarrjes, prandaj jemi duke bërë përpjekje me të gjitha resurset të vihen në dispozicion të gjitha burimet njerëzore dhe burimet financiare që të minimizohen humbjet teknike dhe eliminohen në tërësi humbjet administrative të ujit nga njëra anë dhe të maksimizojnë të gjitha aktivitetet lidhur me rritjen e shkallës së arkëtimit.

Meqenëse ky është prioriteti i parapërcaktuar: -Zvogëlimi i sasisë së ujit të pa faturuar si dhe rritja e normës së pagesave të konsumatorëve për shërbimet duke reflektuar në rritjen e qëndrueshmërisë financiare dhe furnizim me ujë 24/7 sasior dhe cilësor atëherë së bashku me palet e treta e sidomos me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit do të përafrojmë objektivat e caktuara edhe pse deri më tani një pjesë bukur e madhe ka reflektuar në rënie të indikatorëve kryesorë të ndermarrjes sidomos në periudhën mars – maj 2020.

Tani menaxhmenti i ndermarrjes së bashku me bordin e drejtorëve dhe me palet e treta ka filluar orientimin e fuqishëm edhe në drejtim të Institucioneve financiare dhe Donatorëve ku realizimi dhe arritja e caqeve të planifikuara sidomos në pjesën financiare tek investimet kapitale është i varur nga mjetet financiare ndaj duhet përkrahje edhe nga burimet tjera të sigurohen mjete si nga donatorët , Institucionet financiare si dhe institucionet qendrore dhe lokale .

Bordi i Drejtorëve,Menagjmenti si dhe të gjithë të punësuarit do të jenë të anagzhur maksimalisht që me punën e tyre të realizojnë objektivat që dalin nga caqet e planifikuara edhe pse një gjë e tillë siq është tani Pandemia nuk është planifikuar se do të ndikojë në masë të madhe në rënie të indikatorëve kryesorë sidomos në pjesën financiare prandaj mobilizimi i përbashkët e lehtëson që Kompania të arrijë një qëndrueshmëri financiare që të ofrojë shërbime cilësore për konsumatorët.

Orientimi i të gjitha aktiviteteve të punës do të kenë për fokus konsumatorin me të gjitha përfitimet dhe rreziqet pa asnjë diskriminim, ku të gjithë konsumatorët do të kenë trajtim human dhe çasje në shërbim për ujë dhe ujëra të zeza.

KRU"Prishtina" me të gjitha kapacitetet për punë, po mundohet të iu ofrojë shërbime gjithnjë e më cilësore me ujë dhe kanalizim. Në të njëjtën kohë , furnizimi me ujë të pijshëm dhe cilësor po bëhet pa ndërprerë. Duke qenë të gjithë të njoftuar lidhur me situatën e Pandemisë, që po zhvillohet për shkak të Coronavirusit (i njohur gjithandej si COVID-19) dhe masat që kemi marrë, edhe më tutje jemi të përkushtuar dhe do të bëjmë përpjekje maksimale, që ta përmbushë misionin që kemi furnizim me ujë 24/7 , për t'u siguruar qytetarëve shërbime cilësore.

Për më tepër, ne dëshirojmë t'ju informojmë se, momentalisht, për shkak të gjendjes së krijuar në terren nga COVID-19, jemi duke punuar me staf të reduktuar në rastet kur i punësuarit nuk ndihet mirë apo në rastet kur i punësuarit del me covid pozitiv duke i respektuar rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik ndaj

posa të sigurohen kushtet minimale për zhvillimin normal të aktiviteteve do të fillojme me normalizimin e situatës.

Duke pasur parasysh vështirësitë, që janë duke u shfaqur në procesin funksionimit si në aspektin Teknik-operativ ashtu edhe nga aspekti financiar, vonesat nga afatet e përcaktuara për pagesa të shërbimeve veq tani vërehen dukshëm sidomos nga muaji mars 2020 e tutje. Nga muaji qershor 2020 k filluar nje stabilizim idukshem ne kthimin e gjendjes nga aspekti I arkëtimit të faturve mujore.

Në bazë të vendimeve dhe qëndrimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, kemi qenë të obliguar të reduktojmë angazhimet dhe aktivitetet e përgjithshme në nivelin e masave të punëve esenciale; në bazë të kërkesave dhe udhëzimeve nga IKSH, që sa më shumë ta parandalojmë përhapjen e koronavirusit (COVID-19), respektivisht të fokusohemi vetëm në aktivitete operative me prioritet.

Kjo ka ndikuar edhe në aktivitetet tona karshi arkëtimeve për këtë periudhë për këtë arsye janë zvogëluar kontaktet me konsumatorë, që janë në interesin tonë të ndërsjelltë duke I informuar për obligimet mujore që I kanë ndaj ndërmarrjes për shërbimet e ujit.

Nga e gjithë kjo bashkëngjitur gjeni në formë tabelare dhe grafike ndikimin direkt në aspektin financiar sa I përket arketimeve për periudhën nga kur ka filluar pandamia në vendin tonë.

Tabela 1- Foramti 1


Të hyrat dhe realizimi - janar shtator 2020

Muaji. Viti	Faturimi Total	Inkasimi Total	Gjithsej te Papaguara	% realizimi	% e faturave të pa paguara
1. 2020	1,311,132	1,060,047	251,084	81%	19%
2. 2020	1,255,451	1,090,216	165,235	87%	13%
3. 2020	1,202,362	696,333	506,029	58%	42%
4. 2020	1,114,662	527,445	587,218	47%	53%
5. 2020	1,232,584	922,586	309,998	75%	25%
6. 2020	1,274,219	1,017,675	256,544	80%	20%
7. 2020	1,217,550	1,000,049	217,501	82%	18%
8. 2020	1,213,429	1,056,879	156,550	87%	13%
9. 2020	1,275,585	1,108,786	166,800	87%	13%
	11,096,973	8,480,014	2,616,960	77%	23%


Lidhur me vlerësimin e rëndësisë së problemit në lidhje me sfidat (tabela 1) e nxjerrë nga kompania, tregon se pamjaftueshmëria e mjeteve financiare për të ofruar qendrueshmeri financiare është problematika më e mprehtë duke shënuar një ulje të realizimit të inkasimeve deri në 77% e vleres së faturuar nga janar deri më shtator 2020. Identifikimi i kategorive të cënueshme dhe numri i pakët i punonjësve në dispozicion për shkak I reduktimit të stafit ka reflektuar në përmbushjen e aktiviteteve ditore ndaj këto ishin sfidat e tjera më të rëndësishme, të cilat shënuan rënie.

Përkundrazi, sipas raportimeve të bashkëngjitura, kushtet për punë aktive gjatë pandemisë nuk e ndalen së funksionuari menaxhmenin që të kemi ofrim të shërbimeve 24/7 për të gjithë konsumatorët në zonen e shërbimit. Krahmenaxhimit të nevojave të ngutshme të konsumatorve për shërbime cilësore dhe sasiore, emergjenca e COVID-19 solli sfide lidhur me realizimin e faturave nga konsumatorët ndaj shërbimeve të pranuar nga kompania. Shërbimet për konsumatorë dhe sfidat në përmbushjen e objektivave u përmbledhën në këtë dokument, në mënyrë që ndërmarrja të ofrojë informacion lidhur me vështirësitë që jemi duke hasur në ofrimin e shërbimeve dhe arritjen e objektivave që prej fillimit të krizës së COVID-19 në vend.

Grafiku 1- Foramti 1



Grafiku 2 – Formati 2



Nga informacionet qe shifen ne tabelë dhe garfikon mund të konkludojmë se vlera e borxheve të qytetarëve ndaj kompanisë KRU “Prishtina” sh.a nga fillimi i pandemisë është mbi 2 milion euro.

Dallimet në pagesa gjatë kohës së pandemisë dhe kohës sa nuk ka qenë e pranishme pandemia në vendin tonë është e dukshme dhe ka ndikuar shumë në nivelin e të hyrave të kompanisë duke ditur se kompania ka shpenzime të mëdha për operim dhe distribuim ndaj kjo ka ndikuar shumë ngase për operim të mirëfilltë kompania ka kosto bukur të mëdha në aktivitete si nga aspekti sasior në prodhim ashtu edhe në distribuim po ashtu edhe nga aspekti cilësor i shërbimeve të ujit.

Cdo faturë e pa paguar për shërbimet e ujit dhe kanalizimt ndikon direkt në kthim të investime afatgjate infrastrukture.

SWOT analiza për treguesit e përfomances

Dokumenti është një përmbledhje e shkruar e aktivitetit të propozuar të ndërmarrjes ku varësisht nga nevoja dhe synimet e ndërmarrjes dhe këto aktivitete të propozuara mund të jenë afatshkurtëra ose afatgjate.

Duke qene se nga këndi i structures së SWOT (Strength, weakness, opportunities and threats) analiza bëhet një katror i madh me katër nën katrorë në të cilët numrohen, pra vetëm numërohen dhe analizohen elementet e kërkuara (si më poshtë):

Faktorët e brendshëm

Faktorët e brendshëm-përparësitë

- Kontrollimi në shkallën optimale të resurseve:
- Njerëzore
- Logjistike
- Financiare
- Potenciali dhe struktura e konsumatorëve.

Faktorët e brendshëm-dobësitë

- Pamundësia përkatësisht ngecja e të gjitha njësive operative për arritjen e shkallës mesatare të së arkëtimit në nivel të shkallës së arkëtimit në nivel të qytetit Prishtinë përkatësisht të KUR "Prishtina" sh.a.
- Pamundësia (edhe për arsye teknike) në shkëputjen e konsumatorëve që në vazhdimësi kanë refuzuar pagesën e faturave të ujit (në të shumtën e rasteve shkyçja është përcjellë me pengesa fizike për shkyqje nga konsumatorët). Por janë të shumta rastet kur pasi të jenë shkyçur një numër i konsumatorëve janë ri kyçur pa pëlqimin e KUR "Prishtina" sh.a.
- Mos mbulimi i plotë i të gjithë konsumatorëve me ujëmatës të lexueshëm,
- Marketingu ende në një shkallë jo të mjaftueshme për pagesa dhe kurse të ujit,
- Problemet në leximin e matësve përkatësisht kontestimi i faturave për shkak të faturimit paushall.

Faktorët e jashtëm

Faktorët e jashtëm-përparësitë

- Struktura e mirë e konsumatorëve (koncentrimi më i madh i bizneseve,institucioneve etj në zonën e shërbimit)
- Tarifa më e lartë dhe e favorshme në këtë kategori të konsumatorëve
- Pozita e favorshme socio-ekonomike e konsumatorëve

Faktorët e jashtëm-dobësitë

- Mospagesa e rasteve sociale-Qeveria e Republikës së Kosoves nuk bënë rimbursimin për konsumatorët që janë të përfshirë në skemat e ndihmës sociale (një gjë të tillë në mënyrë të vazhdueshme bënë për KESKO),
- Shkalla e ulët e përgjigjes për pagesë të ujit nga pjesa dërmuese e komunitetit serb,
- Mos azhuriteti i gjykatave,në përfundimin e më shumë se 5.000 kërkesave për përmbarrim dërguar në gjykatën kompetente,
- Mbështetja e pamjaftueshme të komunave dhe ministrive përkatëse që të ndikohet (kushtëzohen sikurse në rastin e KEDS dhe tatimit në pronë) në konsumatorë që të paguhet faturat e ujit,
- Mos zgjidhja e pagesës së borxheve të prapambetura nga shitja e ndërmarrjeve të privatizuara,
- Jogatishmëria e organeve policore në dhënien e ndihmës (sigurisë fizike të personelit) gjatë procesit të shkyçjeve (kjo është zgjidhur duke paguar mjete financiare shtesë për policinë që ka asistuar në shkyqje).
- Ndërrimi i shpeshtë i pronarëve përkatësisht ndërrimi i shfrytëzuesve të këtyre hapësirave banesore-qiraja

- Mospagimi i një pjesë të borxheve të akumuluar nga vitet paraprake e që i adresohen shumë Organizatave Buxhetore (Forca e Sigurisë, Arsimi parauniversitar, Shëndetësia primare Organet e administratës komunale etj).
- Rënja e fuqisë blerëse të konsumatorëve, rritja e kostos së jetesës (karburanteve, vajit, transportit, miellit dhe bukës etj).

Përmbledhje Ekzekutive

Qëllimi i këtij raporti është detalizimi i një situatë të krijuar si dhe plani strategjik për zbatimin e të cilit do të synojmë përmirësimin e performancës operacionale dhe financiare të kompanisë. Kapaciteti i burimeve njerezore dhe pasiguria rregulluese gjatë kohës së pandemisë kanë kontribuar në një klimë jo të favorshme në ndërmarrje e cila në përgjithësi krijoi një nivel të ulët të realizimit të objektivave financiare dhe investimeve. Kjo situatë i atribuohet gjendjes së krijuar pas shfaqjes së pandemisë në vend si përgjegjës për furnizim me ujë në rimëkëmbjen e ndërmarrjes dhe garantimin e sigurisë së furnizimit 24/7 dhe ujë cilësor.

Ky raport tregon situatën financiare dhe marrjen e masave për të ndihmuar ndërmarrjen për marrjen e vendimeve themelore dhe ndërmarrjen e veprimeve të cilat do të orientojnë kompaninë në arritjen e objektivave strategjike së bashku me aksionarin. Raporti përfshin një analizë financiare dhe faktorët të jashtëm dhe të brendshëm të kompanisë për të identifikuar prirjet dhe paqartësitë, mundësitë dhe rreziqet e saj. Fillimisht, në këtë vlerësohet gjendja aktuale e kompanisë, si brenda ashtu dhe në kontekstin e jashtëm në të cilin operon, duke konkluduar në një analizë SWOT. Në bashkëpunim me aksionarin duhet të procedohet me përcaktimin e objektivave duke identifikuar boshllëqet dhe mundësitë reale të kompanisë për realizimin e këtyre objektivave dhe kalimin e situatës së krijuar në ndërmarrjen KRU Prishtina.

I. Analiza e pasqyrave financiare: Përdoruesit e treguesve financiarë

Analiza e pasqyrave financiare është një proces gjykimi që synon të vlerësojë pozicionin financiar të kaluar dhe atë të tashmin në një kompani.

Objektivi parësor i saj është përcaktimi, parashikimi dhe vlerësimi më i mirë i kushteve ekonomike dhe performances në të ardhmen. Përpjekjet për të bërë një analizë financiare i shohim në çdo organizatë të pajisur me autonomi financiare.

Analiza e pasqyrave financiare është një metodë e krahasimit, gjykimit ose e vlerësimit të gjendjes së vlerave të pjesëve të caktuara të bilanceve, në bazë të cilave merrën vendimet e rëndësishme. Pra, analiza financiare, është një analizë e bilanceve për të kaluarën, të tashmën dhe të ardhmën e ndërmarrjes.

Vlerat e pozicioneve të bilanceve veç e veç nuk kanë rëndësi të larta analitike. Por, nëse ato i krahasojmë me vlerat e pozicioneve të tjera të bilancit atëherë vlera krahasuese e tyre rritet.

*Për shembull, nëse i pjestojmë të hyrat nga shitja me numrin e blerësve, atëherë fitojmë një tregues mbi xhiron për një të punësuar që është një tregues i rëndësishëm mbi produktivitetin e ndërmarrjes.

Objektivi i pasqyrave financiare është dhënja e informacioneve rreth pozicionit financiar, performancës financiare dhe ndryshimeve në pozicionin financiar të një entiteti, të cilat janë të përdorshme prej një game të gjerë përdoruesish në marrjen e vendimeve të tyre ekonomike.

Pasqyrat financiare paraqesin fazën përfundimtare të procedimit të të dhënave të kontabilitetit dhe paraqiten si bartës të informative kontabile.

Pasqyrat financiare janë prezentime financiare të strukturuar të gjendjes financiare dhe transaksioneve të kryera nga ana e ndërmarrjes.

Sipas SKK, SNK/IAS, pasqyrat financiare sigurojnë informacion për:

- Mjetet
- Detyrimet
- Kryegjënë
- Të hyrat dhe të dalat
- Rrjedhjen e parasë.

Pasqyrat financiare janë të nevojshme, sepse ato ndihmojnë përdoruesit e ndërmarrjes / menaxhmentin , të marrin vendime ekonomike të drejta, si dhe të kuptojnë raportimin financiar me qëllim që të përmirësojnë vendim marrjen brenda ndërmarrjes.

1. Kompania Ujësjiellësi Rajonal "Prishtina" sh,a - Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare 09/2020

Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare jep informacion të vlefshëm financiar për kompaninë për të caktuar, sidomos kur veprimtaria e saj shtrihet prej disa vitesh dhe shqyrtohet bashkërisht me pasqyrat e tjera financiare.

Që të mund ta realizojmë këtë objektiv, Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare duhet të jetë lehtë e lexueshme dhe duhet të dimë ta lexojmë atë. Por, sidoqoftë duhen njohur paraprakisht llogaritë bazë të bilancit, kuptimi i tyre, funksionimi dhe lidhja e secilës llogari me pasqyrën e konsoliduar e pozitës financiare dhe me pasqyrat tjera financiare.

Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare është thjeshtë një listë e të gjitha pasurive që biznesi zotëron dhe të gjitha detyrimeve që ai ka në një datë të caktuar. Mund të demonstron me një fotografi të pozicionit financiar të kompanisë në një moment të caktuar.

Secilës pasuri dhe detyrim i caktohet një shumë përkatëse monetare. Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare në ndërmarrje jep përgjigje se çfarë kanë investuar menaxhmenti i saj. Me fjalë tjera Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare, paraqet një lloj të pasqyrës krahasuese tabelare dyanësore, në njëren anë pasqyrohen të gjitha mjetet dhe në anën tjetër të gjitha burimet e mjeteve me të cilat disponon kompania në një datë të caktuar.

Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare paraqitet në formë të pasqyrës së dyanshme:

- në anën e majtë – Aktiv (ku përfshihen astete të tilla si; toka, ndërtesa, makinat, mjetet monetare,
- në anën e djathtë – Pasivi (ku paraqiten detyrimet dhe kapitali i pronarit/ve).

Pasuritë ndahen në aktive afatgjata (ose të qëndrueshme) dhe pasuri afatshkurta (ose qarkulluese). Në pasuri të qëndrueshme hyjnë ato pasuri të cilat e kanë afatin e përdorimit më të gjatë se një vit.

Pasuritë e qëndrueshme ndahen në:

- pasuri materiale dhe
- pasuri jo materiale.

Në pasuritë materiale hyjnë:

- toka,
 - ndërtesat,
 - pajisjet e ndryeshme, etj.,
- në aktive jomateriale hyjnë:

- patenta,
- licenca,
- marka tregtare,
- goodwill, etj.

Ndërsa në pasuri qarkulluese hyjnë ato pasuri të cilat e kanë afatin e përdorimit më të shkurtë se një vit, e ku bëjnë pjesë:

- paraaja e gatshme,
- depozitat në bankë,
- llogaritë e arkëtueshme,
- shpenzimet e parapaguara,
- inventarët, etj.

Paraqitja e Pasqyrës së konsoliduar të pozitës financiare, sikurse do ta shikojmë më poshtë, mundëson ndër të tjera matjen e kredibilitetit të ndërmarrjes (dmth aftësinë e ndërmarrjes, në një moment të dhënë, për të paguar borxhet).

Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare lejon gjithashtu edhe analiza të tjera të gjendjes së ndërmarrjes, të cilat do t'i gjeni në vijim.

Kompania Ujësja Rajonal "Prishtina" sh.a - Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare më Gjendja me 30 shtator 2020

	Shënimi	Gjendja me 30 shtator 2020	Gjendja më 31 dhjetor 2019
		€	€
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	1	4,996,754	4,636,339
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera Neto	2	18,181,244	15,168,815
Parapagimet- rritje e LL/A	3	160,867	204,476
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	4	18,342,111	15,373,291
Stoqet	5	1,583,250	1,536,023
Instrumentet financiare derivative		-	-
Pasuritë financiare sipas vlerës së drejtë		-	-
Pasuritë e klasifikuara si të mbajtura për shitje		-	-
Pasuritë e tjera afatshkurtra-Kerkesat tjera	6	533,781	534,591
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		25,455,895	22,080,245
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	7	84,696,251	89,725,328
Prona, pajisjet dhe impiantet e rivleresuara -Teprica	8	17,804,891	18,938,574
Investimet e mbajtura deri në maturim		-	-
Pasuritë financiare të mbajtura për shitje		-	-
Investimet e trajtuara sipas metodës së ekuitetit		-	-
Prona investuese		-	-
Investimet në vijim		697,920	492,264
Emri i mirë		-	-
Pasuritë e paprekshme		-	-
Pasuritë e shtyra tatimore		-	-
Pasuritë e tjera afatgjata		-	-
Gjithsej pasuritë afatgjata		103,199,062	109,156,166
Gjithsej pasuritë		128,654,957	131,236,411
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	9	698,083	1,216,257
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër		2,422,000	2,322,000
Tatimet e pagueshme aktuale	10	635,041	511,613
Të hyrat e shtyra		-	-
Provizionet afatshkurtra		-	-
Përfitimet e punonjësive të pagueshme		-	-
Detyrimet ndaj takses MMPH-afatshkurter		154,326	-
Detyrimet e tjera afatshkurtra-Avanset e marra	11	160,867	204,476
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		4,070,317	4,254,346
Detyrimet afatgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë	12	30,218,638	31,873,098
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë- kredia	13	12,468,000	13,679,000
Provizionet afatgjata		-	-
Detyrimet ndaj lizingut, pjesa afatgjatë		-	-
Detyrimet ndaj takses MMPH-afatgjate		300,283	-
Detyrimet e shtyra tatimore		130,158	-
Përfitimet e punonjësive të pagueshme		-	-
Detyrimet e tjera afatgjata		-	-
Gjithsej detyrimet afatgjata		43,117,079	45,552,098
Gjithsej detyrimet		47,187,396	49,806,444
EKUITETI			
Kapitali aksionar	14	25,000	25,000
Te mrat e marre Gratis	15	104,844	104,846
Fitimet e mbajtura	16	(10,349,207)	(10,320,773)
Rezervat e tjera	17	72,710,753	72,710,753
Teprica nga rivleresimi	18	17,804,891	18,938,574
Fitimi/Humbja e vitit	19	1,171,420	(28,434)
Gjithsej ekuiteti për pronarët e ndërmarrjes mëmë		81,467,562	81,429,967
Interesi jo-kontrolluese		-	-
Gjithsej ekuiteti		81,467,562	81,429,967
Interesi jo-kontrolluese		-	-
Gjithsej ekuiteti		81,467,562	81,429,967
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		128,654,957	131,236,411

2. Kompania Ujësjiellësi Rajonal "Prishtina" sh,a - Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave gjithëpërfshirëse 09/2020

Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave gjithëpërfshirëse është një regjistër i të hyrave të gjenruara dhe shpenzimeve të ndodhura për një periudhë kohore. Kjo pasqyrë tregon nëse kompania ka pasur më shumë të hyra se sa shpenzime (pra fitim) ose e kundërta (humbje). Pasqyra e të ardhurave reflekton efektet operative menaxheriale në përmasat e biznesit dhe rezultatin e tyre në fitim apo humbje për pronarët e kompanisë gjatë një periudhe të caktuar kohore. Fitimi apo humbja e llogaritur në pasqyrën e të ardhurave rrit apo zvogëlon pasurinë e aksionarit në bilancin e gjendjes.

Kompania Ujësjiellësi Rajonal "Prishtina" sh,a

Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon			Gjendja me 30 shtator 2020
	Shënimi	Gjendja me 30 shtator 2020	Gjendja më 31 dhjetor 2019
		€	€
Të hyrat nga shërbimi i furnizimit me ujë	1	10,217,134	14,392,389
Të hyrat nga grantet	2 .3/4	1,654,460	2,205,947
Te hyrat Subvencionet	3	1,500,000	
Te hyrat Operative nga Provizionimet	4 .3/4	485,768	647,691
Të hyrat tjera operative	5 .3/4	95,563	219,214
Fitimi / (humbja) bruto		13,952,925	17,465,241
Të ardhurat tjera			
Shpenzimet për blerje Uji të paperpunuar	5	(618,768)	(748,043)
Shpenzimet e energjisë	6	(1,682,294)	(2,246,257)
Shpenzimet e karburanteve	7	(90,319)	(117,378)
Shpenzimet e personelit-paga dhe medijtje	8	(4,039,550)	(5,423,537)
Shpenzimet materiale	9	(286,672)	(525,818)
Sherbimet e jashtme kontraktuese	10	(358,169)	(875,867)
Shpenzimet e rek., sportit, kultures dhe nd. solidare	11	(6,512)	(5,378)
Shpenzimet e mirembajtjes dhe riparimit	12	(132,744)	(115,319)
Te dalurat financiare dhe transferi i rezultetit fin.	13	(18,013)	(13,408)
Shpenzimet e zhvleresimit dhe amortizimit	14 .3/4	(5,173,050)	(6,878,204)
Shpenzimet e zhvleresimit nga teprica e rivleresimit 2019		-	
Shpenzimet e provizionimit te borxhit te keq	15 .3/4	(55,615)	(74,153)
Shpenzimet administrative	16	-	-
Fitimet/humbjet tjera - neto	17		-
TOTALI - Shpenzimet operative		(12,461,707)	(17,023,362)
Fitimi / (humbja) operativ		1,491,219	441,879
Te hyrat nga teprica e rivleresimit	5		
Shpenzimet financiare-taksas se MMPH 2011-2017	18 .3/4	(59,004)	(78,672)
Shpenzimet e Interesit	19 .3/4	(160,016)	(417,670)
Të ardhurat financiare	20	29,380	26,029
Fitimi / (humbja) para tatimit		1,301,578	(28,434)
Shpenzimet e tatimit në fitim	21	(130,158)	0
Fitimi / (humbja) pas tatimit		1,171,420	(28,434)
Shpenzimet e denimeve, penaleve, gjobave, interesave etj.			
Fitimi / (humbja) i/e vitit	22	1,171,420	(28,434)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:			
Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave financiare te operacioneve të huaja, neto nga tatimi		-	-
Prona, pajisjet dhe impiantet e rivleresuara -Teprica	23		18,938,574
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit			18,938,574

3. Kompania Ujësjellësi Rajonal "Prishtina" sh.a - Pasqyra e konsoliduar e rrjedhjes së parasë 09/2020

Pasqyra e konsoliduar e rrjedhjes së parasë është një pasqyrë shtesë e dobishme e pasqyrave financiare të kompanisë për arsye se fitimi i kontabilitetit nuk është i vetmi tregues i performancës së kompanisë. Pasqyra e konsoliduar e rrjedhjes së parasë përqendrohet mbi burimet dhe përdorimet e parasë së gatshme dhe është një tregues i rëndësishëm i likuiditetit dhe aftësisë për të paguar të një kompanie. SNK 7 kërkon që Pasqyra e konsoliduar e rrjedhjes së parasë t'i raportojë rrjedhjat e parasë gjatë periudhës duke i klasifikuar si prej:

aktiviteteve operacionale,
aktiviteteve investuese dhe
aktiviteteve të financimit.

Mënyra e paraqitjes së rrjedhjeve të parasë nga këto tre aktivitete varet nga natyra e entitetit. Duke i klasifikuar rrjedhjet e parasë nëpër aktivitete të ndryshme, në këtë mënyrë përdoruesit mund të shohin ndikimin e parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj mbi secilin lloj të aktiviteteve, dhe marrëdhënjet e tyre me njëra tjetrën.

Aktivitetet operacionale

Kjo është mbase pjesa kyçe e Pasqyrës së konsoliduar e rrjedhjes së parasë për arsye se ajo tregon nëse, dhe në qfarë mase, kompania është e aftë të gjenerojë para të gatshme prej operacioneve të tyre. Janë këto rrjedhje operacionale të parasë të cilat duhet, në fund të fundit të paguajnë për të gjitha daljet e parave të gatshme prej aktiviteteve të tjera, parapagesat e interesit të kredive, dividendët dhe kështu me radhë. Shumica e përbërësve të rrjedhjeve të parasë prej aktiviteteve operacionale do të jenë ato zëra të cilët përcaktojnë fitimin neto ose humbjen neto të entitetit, pra ato kanë të bëjnë me aktivitete kryesore që gjenerojnë të hyra në entitet.

Aktivitetet investuese

Pasqyra e konsoliduar e rrjedhjes së parasë të klasifikuara sipas këtij tiulli tregojnë nëse sa investime janë bërë në pasuri të cilat do të shërbejnë për të gjenruar fitime dhe rrjedhje të arkës në të ardhmen. Standardi jep shembujt e mëposhtëm të rrjedhjave të arkës që vijnë si rezultat i aktiviteteve investuese:

(a) Pagesat në para të gatshme për të përftuar (blerë) pasuri të patundshme, impiante prodhimi dhe pajisje, pasuri të patrupëzuar dhe pasuri të tjera jo-qarkulluese, përfshirë këtu ato që kanë të bëjnë me kostot e kapitalizuara të zhvillimit dhe pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe pajisjet e ndërtuara vetë,

(b) Arkëtimet e parasë së gatshme prej shitjes së pasurive të patundshme, impinateve të prodhimit dhe pajisjeve, pasurive të patrupëzuara dhe pasurive tjera jo-qarkulluese,

(c) Pagesat në para të gatshme për të përftuar (blerë) aksione ose obligacione të entiteteve tjera,

(d) Arkëtimet e parasë së gatshme prej shitjes së aksioneve ose obligacioneve të entiteteve tjera,

(e) Avancat në para të gatshme dhe kreditë e mundësuar ndaj palëve të treat,

(f) Arkëtimet e parasë së gatshme prej ripagimit të avanceve dhe kredive,

Aktivitetet e financimit

Kjo pjesë e pasqyrës së rrjedhjeve të parasë tregon atë pjesë të parave të gatshme e cila është pretenduar nga dhënësit e kapitalit të entitetit gjatë periudhës. Kjo është një tregues i pagesave të ardhshme për inters dhe dividend.

Standardi jep shembujt e mëposhtëm të rrjedhjave të arkës të cilët mund të përmbliken nën këtë titull:

(a) Paratë e gatshme të marra prej emitimit të aksioneve,

(b) Pagesat në para të gatshme ndaj pronarëve për të blerë ose rimbledhur aksionet e entitetit,

(c) Paratë e gatshme të marra prej marrjes së kredive, emitimit të obligacioneve, dëftesave, bonove, marrjes së kredive hipotekare dhe huave të tjera afatshkurtra ose afatgjata,

(d) Pagesat e parasë së gatshme për shumat e marra hua.

Kompania Ujësjetllësi Rajonal "Prishtina" sh.a

Pasqyra e konsoliduar e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon

	Shënimi	Gjendja me 30 shtator 2020	Gjendja më 31 dhjetor 2019
		€	€
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi / (humbja) i / e vitit	1	1,171,420	(28,434)
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave			
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	2	5,173,050	6,878,204
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve			
Amortizimi i pasurive të paprekshme			
Humbjet nga dëmtimi në pasuritë e paprekshme			
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese			
Të ardhurat financiare - Grantet	3	(1,654,460)	(2,205,947)
Të ardhurat financiare	4	(29,380)	(26,029)
Shpenzimet financiare-Provizionim	5	55,615	74,153
Shpenzimet financiare-taksas se MMPH 2011-2017	6	59,004	
Tatimi i pagueshem aktual	7	-	-
(Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve			
Shpenzimet e tatimit në fitim	8	130,158	
		4,905,407	4,691,946
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	9	(3,012,593)	(1,284,790)
		(47,226)	68,336
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe	10	810	1,433,342
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë (kerkesat) e tjera	11	(122,569)	167,955
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	12	123,428	(324,233)
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme -Det Paga	13		
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet afatgjate te tjera-Te hyrat e shtyra	14		
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative Total		(3,058,151)	60,609
Tatimi në fitim i paguar		130,144	-
Interesi i paguar Kredia	15	(160,016)	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		1,687,241	4,752,556
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	16	(10,331)	(1,721,444)
Investimet ne vijim	17	(205,659)	(492,264)
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve		-	-
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme		-	-
Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme		-	-
Interesi i arkëtuar		-	-
Dividendat e arkëtuara		-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		(215,990)	(2,213,708)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Deponimet e kapitalit shtesë		-	-
Dividendat e paguara		-	-
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë		0	0
Ripagimi i kredive dhe huave	18	(1,111,000)	(2,222,000)
Pagesat e lizingut financiar		-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		(1,111,000)	(2,222,000)
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë	19	360,415	316,847
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	20	4,636,339	4,319,492
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	21	4,996,754	4,636,339

4. Kompania Ujësjetlësi Rajonal "Prishtina" sh,a - Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në ekuitet

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në ekuitet, sipas parashikimeve të bëra në SKK 2, ndërtohet për të siguruar informacion në lidhje me ndryshimet në kapitalin e ndermarrjes dhe të faktorëve që kanë ndikuar në këto ndryshime. Në këtë pasqyrë duhet të jepet informacion në lidhje me gjendjen në fillim të periudhës (apo në fund të periudhës raportuese) të kapitalit të vet, e klasifikuar kjo gjendje sipas paraqitjes në Bilancin Kontabël, e shtesave dhe pakësimeve të kësaj gjendje nga kontributet apo tërheqjet e kapitalit nga pronari, nga rezultati i aktivitetit të ndermarrjes, nga rezervimet e fitimit, nga shpërndarja e dividendëve.

Kompania Ujësjetlësi Rajonal "Prishtina" sh,a

	Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon më			Gjendja me 30 shtator 2020		
	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat e tjera	Gjithsej atribuar pronarëve të ndermarrjes mëmë	Gjithsej interesi jokontrollues	Gjithsej
	€	€	€	€	€	€
Gjendja më 1 janar 2018	25,000	(9,568,930)	72,620,753	-	-	63,076,823
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	(751,015)	-	-	-	(751,015)
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-	-	-
Dividendat	-	-	-	-	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	-	-	-	-
Ndarja e rezervave	-	-	89,173	-	-	89,173
Gjendja më 31 dhjetor 2018	25,000	(10,319,945)	72,709,926	-	-	62,414,981
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	(28,434)	-	-	-	(28,434)
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-	-	-
Dividendat	-	-	-	-	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	104,844	-	-	104,844
Ndarja e rezervave (rivlersimi)	-	-	18,182,785	-	-	18,182,785
Gjendja më 31 dhjetor 2019	25,000	(10,349,207)	90,997,555	-	-	81,429,967
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	1,171,420	-	-	-	1,171,420
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-	-	-
Dividendat	-	-	-	-	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	-	-	-	-
Ndarja e rezervave (rivlersimi)	-	-	(1,133,825)	-	-	(1,133,825)
Gjendja me 30 qershor 2020	25,000	(9,046,799)	90,619,661	-	-	81,467,562

5. Raporti i performancës - Bazuar në muajt e vitit 2020

Performanca mujore		Planifikimi 2020	Janar 2020	Shkurt 2020	Mars 2020	Prill 2020	Maj 2020	Qershor 2020	Korrik 2020	Gusht 2020
Kategoria	Pershkrimi	Planifikuar	E Realizuar							
Prodhimi	Uji i distribuar (m3)	49,594,948	4,503,100	4,053,593	4,438,899	4,254,521	4,351,965	4,356,296	4,922,080	4,4
	Uji i faturuar (m3)	25,594,950	1,916,182	1,845,361	1,763,290	1,679,786	1,892,033	1,933,925	1,824,631	1,8
	Uji i pa faturuar (m3)	23,999,998	2,586,918	2,208,232	2,675,609	2,574,735	2,459,932	2,422,371	3,097,449	2,6
	Uji i pa faturuar %	48%	57%	54%	60%	61%	57%	56%	63%	
Numri i Konsumatorëve	Konsumatorët e regjistruar	160,021	156,494	156,494	157,567	157,804	158,051	158,790	159,052	1
	Nr. i faturave të lëshuara	145,112	142,509	142,769	143,435	143,790	143,961	144,754	144,870	1
	Konsumatorët e regjistruar - pasiv	14,909	13,985	13,725	14,132	14,014	14,090	14,036	14,182	
	Konsumatorët e regjistruar - pasiv	9%	9%	9%	9%	9%	9%	9%	9%	
Konsumatorët me matje	Faturimi sipas leximit të ujematesave	142,210	139,053	140,540	140,010	140,370	140,544	141,364	141,514	1
	Faturimi me taksë fikse (pa shpenzimi m3)	-	42,839	44,138	43,307	45,909	51,309	46,772	44,419	
	Nr. i faturave të lëshuara - pa shpenzim, pa matje	2,902	3,456	2,229	3,425	3,420	3,417	3,390	3,356	
	Faturimi paushall %	2%	2%	2%	2%	2%	2%	2%	2%	
Konsumatorët me matje	Uji i faturuar per konsumatorët me ujematesa (m3)	24,571,152	1,914,124	1,843,229	1,761,187	1,677,683	1,889,930	1,931,867	1,822,457	1,8
	Uji i faturuar per konsumatorët pa ujematesa (m3)	1,023,798	2,058	2,132	2,103	2,103	2,103	2,058	2,174	
	Uji i faturuar per konsumatorët pa ujematesa në %	4%	0.11%	0.12%	0.12%	0.13%	0.11%	0.11%	0.12%	
	Uji i faturuar nga shërbimi primar	16,044,946	1,215,067	1,163,400	1,114,203	1,032,985	1,141,935	1,180,645	1,128,171	1,1
Faturimi në Euro	Uji i PA faturuar ne raport me tarifen e ujit te faturuar	25,594,950	1,327,606	1,133,265	1,373,123	1,321,354	1,262,437	1,243,161	1,589,611	1,3
	Tarifa mesatare faturimi € / m³	€	€	€	€	€	€	€	€	€
Konsumatorët me matje	Faturat e Inkasuara në euro	15,246,927	979,551	1,010,489	645,452	488,767	855,606	942,641	926,639	9
	XX. NJOU Graçanice	2783	452
	XXI. NJOU Fushë Kosovë	1302	148
	XXII. NJOU Podujevë	3612	343
	XXIII. NJOU Kastriot-Obiliq	3166	326

11. DEPARTAMENTET NEN DREJTORIN TEKNIK

Drejtoria Teknike përfshin 4 Departamente dhe një divizione – zyre me të gjitha shërbimet teknike në kuadër të këtyre departamenteve.

Muaji Shtator - Drejtoria Teknike ka arritur të menaxhojë situatën mirë në procesin e prodhimit, distribuimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit të ujit dhe kanalizimit edhe për kundër numrit të limituar të punëtorëve.

Monitorimi i nivelit të liqejeve Batllavë dhe Badovc dhe kualitetit të ujit të pijes në të gjitha pikat prodhuese është indikator i ndërmarrjes, aplikimi i planit për menaxhimin dhe marrjen e masave për kursimet të ujit për përballjen me thatësira, aplikimi i planit të reduktimeve në furnizim të barabartë me ujë të pijes duke pasur parasysh edhe që gjendja në kohë pandemie.

Në fillim të muajit Shtator pas reshjeve të fundit kemi pas disa shqetësime me kualitetin e ujit në liqenin e Badovcit dhe Batllavës paraqitja e manganit në ujin e pa trajtuar, me angazhimin e shërbimit të kualitetit dhe ekipeve në objekteve prodhuese është arritur që gjendja të mbahet nën kontroll dhe të ruajmë kualitetin e ujit të pijes sipas udhëzimeve dhe normave të OBSH-es.

Punët në operim, mirëmbajtjes, planifikimit dhe projektimit mbulohen nga shërbimet me stafin inxhinierik dhe teknik. Problematike në drejtorinë teknike vazhdon të jetë mungesa e stafit, formimi i ekipeve shtese profesionale për mirëmbajtjen dhe planifikimeve preventive. Mungesa e stafit dhe ngarkesave pothuajse të të gjitha departamentet një pjesë e punëve nuk po arrihet të kryhen në kohë si pasojë e ngarkesës së madhe me punë në krahasim me numrin e punëtorëve dhe kualifikimin e tyre.

Është për tu cekur rrjedhja në gypin magjistrat nga Badovci (në pjesën e lëshuesit) dhe problemet në rrjetin shpërndarës në zonës furnizuese nga linja e Badovcit është arritur të sanohet me sukses nga ekipet e mirëmbajtjes.

Kemi ndërmarrë takime me Departamentet teknike për diskutimin e planeve të veprimit, menaxhimin e humbjeve, gjendjen aktuale, menaxhimin e projekteve të planifikuara, vlerësimin e projektit nga donatorët, përgatitjen e projekteve ideore për aplikimin e granteve.

Drejtoria Teknike është duke u ballafaquar me mungesën e burimeve njerëzore posaçërisht shërbimet e mirëmbajtjes, të cilët në një kohë të gjatë nuk janë plotësuar me punëtorë të ri, kështu që kërkojmë plotësimin e vendeve vakante.

Për shkak të pandemisë me COVID-19, janë respektuar rekomandimet e IKSHPK-së për ruajtje të distancës, përdorimin e mjeteve mbrojtëse maska , doreza dhe dezinficiens.

12. RAPORTI NGA DEPARTAMENTI I PRODHIMIT

Në Departamentin e Prodhimit kemi vazhduar me realizimin e planifikimit të prodhimit për muajin Gusht 2020. Prodhimi mujor është afërsisht me planifikimin mujor. Uji primar në Liqejt akumulues ka arrit të ket një kualitet më të mirë ashtu që kemi mundësi që të punojmë me kapacitete optimale. Në FPU SHKABAJ jemi ballafaquar me ngecje të herëpashershme për shkak të ngritjes së turbiditetit në ujin e kanalit, me kohë dhe me preventivë është evituar edhe ky problem.

Edhe nëpër Njësi Operative në Komuna tjera muajin e kaluar kemi një prodhimtari bazuar në kapacitete optimale dhe përshtatur nevojave të kërkesës së prodhimit të ujit të pijes. Zona e furnizimit në Lipjan dhe rrethinë, ka një ndieshmëri të mungesës së ujit pasi që kemi edhe rënjen e nivelit të ujërave nëntoksore si pasojë e thatësirës që po mbizotron kohë të gjatë

Kemi një situat jo të volitshme hidrike në Liqejt Akumulues, të dy liqejt ai i Batllavës dhe i Badovcit, janë në situat jo të mirë për nga nivelit dhe për shkak të mungesës së reshjeve atmosferike, ka tendencë të

vazhdueshme të rënjes së niveli tani gjendja nuk është premtuese që për vitin 2020 dhe një situatë e tillë nëse vazhdohet do të jemi të rrezikuar nga mungesa e ujit primarë në liqej si dhe ujërave nëntokësore për pusët në tërë regionin.

Date 21.09.2020	BATLLAVA	BADOVCI
Niveli i Liqenit	635 max, 630.94 (-4.06m)	649.85 m max , 640.00 (-9.85m)

Prodhimi për vitin 2020 Janar- Shtator

Viti-muaji	TOTALI			
2020	TOTALI I UJIT TË DISTRIB. ~m ³ /muaj~	TOTALI I UJIT TË DISTRIB ~l/s	E PLANIFIKUAR ~m ³ /muaj~	Përqindja e realizuar
Janar	4,525,690	1,681	4,572,029	98.49%
Shkurt	4,053,593	1,618	4,129,574	98.16%
Mars	4,438,899	1,657	4,572,029	97.09%
Prill	4,254,521	1,641	4,424,544	96.16%
Maj	4,351,965	1,625	4,572,029	95.19%
Qershor	4,356,296	1,681	4,424,544	98.46%
Korrik	4,922,080	1,838	4,572,029	107.66%
Gusht	4,488,212	1,676	4,572,029	98.17%
Shtator	4,547,585	1,754	4,424,544	102.78%

Aktivitetet apo përshkrimi i punëve të kryera Brenda muajit raportues

Punët kanë vazhduar me ritmin e zakonshëm sipas planifikimit, qëllimi i trajtimit sa më cilësorë të ujit të pijes ka vazhduar pa ngecje të theksuara, në të gjitha objektet për përpunimin e ujit të pijes.

Specifiko disa nga aktivitetet kryesore;

Aktivitete dhe bashkëpunim me KEDS për ndërprerjet e planifikuara dhe të paplanifikuara të furnizimit me energji elektrike.

Pengesat dhe sfidat gjatë punës;

Ballafaqimi me mungesë të energjisë elektrike në disa nga objektet prodhuese, arsye për punët e planifikuara të KEDS dhe ndërprerje paparalajmërim të energjisë elektrike në raste të mungesës së energjisë elektrike. Përkundër kësaj kohë të fundit nuk kemi ballafaqime të shpeshta me mungesë të energjisë për objektet e KUR Prishtina, sidomos Objektet vitale të prodhimit të ujit të pijes kanë pasur furnizim të pandërprerë me energji elektrike.

Punët e planifikuara dhe shkalla e realizimit të tyre;

Prodhimi i planifikuar për muajin Gusht 2020 është realizuar 98.17% në krahasim me planifikim për Gusht 2020. Arsyetim prodhimi optimal nën kushte të ujit të burimeve pasi që cilësia e ujit primar është në nivel të kënaqshëm. Kemi një shqetësim rreth saktësisë së matjes së ujit të prodhuar në objekte prodhuese. Shqetësimi tjetër është vazhdimi i periudhës së thatësisë së theksuar.

Kritika dhe vërejtjet në menaxhimentin e lartë:

Kritikat vijnë si rezultat i humbjeve të mëdha në Njësit Operative, kemi ndërmarrë takime të ngjeshura që të ndikojmë në zvogëlimin e humbjeve me plane operative dhe plane të shtimit të kontrollit të konsumatorëve ku dyshohet shfrytëzimi i paautorizuar i ujit të pijes.

13. RAPORTI NGJA SHERBIMI I KUALITETIT TE UJIT

Qëllimi kryesor i Departamentit të Kualitetit të Ujit është organizimi dhe funksionimi i tij si Departament për Kontrollen e Kualitetit të ujit duke u bazuar në Standardet cilësore, aplikative (U.A.16/2012) dhe ato europiane (Udhëzimi –Direktiva 98/83/EC) mbi kualitetin e ujit për përdorim nga njerëzit (me pare direktiva 80/778/EEC). Kjo direktivë përcakton dallimet në mes të parametrave mikrobiologjik dhe atyre fiziko- kimik. Aplikimi i standardeve është në interes të gjithë konsumatorët e Prishtinës, F. Kosovë, Obiliqit, Shtimes, Lipjanit, Podujevës, Drenasit, Graçanicës dhe FPU SHKABAJ. Departamenti i Kualitetit të Ujit me planin e tij të monitorimit brendshëm të kualitetit të ujit ka në procedurë pikë së pari mbledhjen marrjen e mostrave të ujit të përpunuar nga rrjeti i ujësjellësit, aeratorëve, liqejeve , puseve dhe lumejve.

Laboratorët shfrytëzojnë metoda standarde për parametrat të cilat janë të aprovume nga BE, sipas procedurës të cilat janë dhënë me Direktivën 98 (93) EC. Mjetet dhe aparatet janë të sofistikuara kurse reagjentët janë të standardizuar dhe me afat. Aplikohet Standardi 17025:2005 ku janë kërkesat që laboratorët e testimit duhet të plotësojnë nëse ato dëshirojnë të demonstrojnë që ato operojnë një sistem menaxhimi.

Aktivitetet apo përshkrimi i shkurtër i punëve të kryera brenda muajit raportues

Sipas planit mujor për monitorimin e brendshëm të kualitetit të ujit në KUR"Prishtina" sh.a, të burimeve sipërfaqësore Albanik, Badovc, Bivolak, Mihaliq (Kanali Ibër-Lepencit) si dhe burimeve nëntoksore Kroni, Obiliq, Shtimje, Lipjan, Peran (Podujevë), Miradi , Graçanicë dhe Vragoli si dhe pesëmbëdhjetë pikat në rrjetin e qytetit , në aplikim të monitorimit të shpejtë bazik dhe vijues kemi percjellë kualitetin e ujit të pijshëm në çdo pikë mostrimi.

Cilësia e ujit është e kontrolluar dhe testuar me analiza fiziko-kimike dhe bakteriologjike sipas parametrave të cilët janë në Listën A dhe C në Udhëzimin Administrativ Nr.16/2012 për cilësinë e ujit për konsum nga njeriu.

Specifiko disa nga aktivitetet kryesore;

Aktiviteti primar gjatë muajit Gusht **2020** ka qenë monitorimi bazik i kualitetit të ujit pijshëm si inspektimi dhe kontrollimi i dozimit të kemikalteve në fabrika si i klorit, kërkesa për furnizim me polielektrolit në objektet prodhuese, testimi dhe kontrollimi i kualitetit të ujit nga FPU "ALBANIK" "BADOVC" dhe "SHKABAJ" si dhe nga NJOU" Lipjan" , "Drenas", "Podujevë,"Shtimje" Kroni", "Kastriot" nga stafi i laboratorit.

Gjatë muajit Shtator ka vazhdu dioksid klorit per dozim ne Badovc, per oksidim te Manganit.

Pengesat dhe sfidat gjatë punës;

Ka pas ngarkese dhe vëllim të punëve ditore te stafi qe ka punuar gjatë tërë muajit për arsye se ka pas shumë ankesa rreth kualitetit të ujit pershkak te presences se algjeve dhe Manganit ne liqenin e Badovcit dhe Batllaves.

Punët e planifikuara dhe shkalla e realizimit të tyre;

Departamenti i Kualitetit të Ujit si prioritet ka kontrollën e cilësise së ujit të pijshëm. Realizimi gjatë muajit Shtator **2020** kanë qenë **1082** mostra total fiziko-kimike dhe bakteriologjike, i cili plan nuk është realizuar për **mostra ose 99.45% te realizuara**. Te planifikuara kanë qenë **1088 total** mostra, nuk janë realizuar **6** mostra për shkak të reduktimeve në disa zona te shërbimit. Te planifikume për mostra te dështuara ose keq (jashtëstandardve) kanë qenë 10 mostra pork y numër është tejkalu përshkak te problemeve me Mangan dhe algje ne Badovc !

Numri i i testimeve të kryera:	541 Mostra fiziko-kimike
	541 Mostra bakteriologjike
	1082 Total mostra fiziko-kimike dhe bakteriologjike
Rezultatet e fituara nga laboratorit:	<u>916 Mostra ujë pijshëm (përpunuar)</u>
	<u>166 Mostra ujë jo i pijshëm (papërpunuar).</u>
	13 (njëmbëdhjetë) mostra jashtë standardit
Rezultatet e raportuara	Në bazë të analizave kimike dhe bakteriologjike të ujit të trajtuar janë testuar 916 mostra të ujit pijshëm ku prej tyre mirë janë 903 ose 98.58% i përgjigjen U.A Nr 16/2012 për cilësinë e ujit për konsum nga njeriu , kurse nuk i përgjigjen trembëdhjetë (13) mostra ose 1.4 2% janë jashtë standardit për ujëra te pijshëm . Në bazë të analizave bakteriologjike dhe fiziko-kimike të ujit të trajtuar 13 (trembëdhjetë) mostra ose 1.42 % janë jashtë standardit për ujëra te pijshëm ku kemi pasë prezencë të baktereve total mezofile , bakterieve koliforme si dhe Mangan . Mostrat jashtë standardit gjatë muajit Shtator 2020 janë : mostra me kod 4133/20 – Cl 0.1mg/l (Rezervuari Mirëditë Prishtinë) - prezent baktere koliforme ; 4235/20 – Cl 0.1 mg/l (Mostra Nr 9 Prishtinë) - prezent baktere koliforme dhe mangan ; 4253/20 – Cl 0.1 mg/l (Mostra Nr 8 Prishtinë) - prezent baktere koliforme, total mezofile; mostra me kod 4272 /20 – Cl gjurme (Lipjan ankese) - prezent baktere koliforme;mostra me kod 4298/20 – Cl 0.1 mg/l (Mostra Nr 2 Prishtinë) - prezent baktere koliforme;mostra me kod 4401 – Cl 0.1 mg/l (Mostra Nr 5 Prishtinë) - prezent baktere koliforme; mostra me kod 4418/20 – Cl 0.3 mg/l (Mostra Nr 2 Kuzmin) - prezent baktere koliforme; mostra me kod 4437/20 – Cl 0.1 mg/l (Mostra Nr 5 Prishtinë) - prezent baktere koliforme; 4441/20 – Cl 0.1 mg/l (Mostra Nr 13 Obiliq) - prezent baktere koliforme; mostra me kod 4503/20 – Cl 0.1 mg/l (Ankesë Prishtinë) - prezent baktere koliforme,mangan ; 4526/20 – Cl 0.1 mg/l (Mostra Nr 8 Prishtinë) - prezent baktere koliforme;mostra me kod 4527/20 –Cl-0.1mg/l (Mostra Nr 9 Prishtinë)- prezent total mezofile dhe mangan dhe: mostra me kod 4552/20 me Cl-0.2 mg/l (mostra me numer 14 Hajvali), turbullire ,mangan dhe total mezofile
	Rezultatet e 166 mostrave te kryera për ujëra të papërpunuar i përgjigjen Standardeve për kualitet të ujit të papërpunuar!
Gjendja e pajisjeve:	E rregulltë dhe funksionale!

Krahasimi i Numrave te mostrave gjatë muajit Shtator **2019** dhe **2020**, total numri i mostrave, mostra mirë dhe keq ne aspektin bakteriologjik për ujërat e përpunuar, total numri i mostrave, mostra mirë dhe keq ne aspektin fiziko-kimik . Në të dy periudhat **2019** dhe **2020** ne aspektin bakteriologjik kemi **7** mostër te dështuara Shtator **2019** kurse gjatë muajit Shtator **2020** kemi **13** mostra të dështuara . Ky numër i mostrave të dështuar tregon se në periudhe kohore 2020 krahasu me periudhën kohore 2019 kemi cilësinë e ujit me kualitet të njëjtë pa ndryshime te mëdha në aspektin mikrobiologjik ,qe do te thotë se gjatë muajit Shtator kemi pas reshura te shiut qe kanë ndikuar me prezence te bakterieve total mezofile dhe koliforme qe vijne si shkak i dheut si dhe punimet e shumta qe po bëhen ne rrugët e qytetit të Prishtinës .Në përgjithësi mund te themi se kemi një kualitet të lartë të ujit pijshëm. Parametrat fiziko- kimik vazhdojne te jenë brenda kufijeve te lejuar te ujit pijshëm në zonat e furnizimit te KRU”Prishtina” sh.a


Viti/muaji	2019/9	2020/9	Viti	2019/9	2020/9
Total mostra FK	491	458	Total mostra Bak.	491	458
Mostra mire	481	456	Mostra mire	484	445
Mostra keq	0	2	Mostra keq	7	13

14. RAPORTI NGA DEPARTAMENTI I MIRËMBAJTJES

- Ne kuadër të këtij Departamenti Operojnë këto shërbime :
 1. Shërbimi i Rrjetit të Ujit,
 2. Shërbimi i Ujëmatësëve,
 3. Shërbimi i Makinerisë,
 4. Shërbimi i Elektrikes
 5. Objektet - Rezervarët në Qytet dhe
 6. Shërbimi i Dispeçereve
- Ky Departament me shërbimet e veta, bënë mirëmbajtjen e të gjitha objekteve dhe paisjeve të KRU "PRISHTINA" SH.A, dhe përgjigjet për gatishmërinë e tyre teknike e funksionale;
- Bënë angazhimin e të gjithë potencialit të vet, të ekspertëve , punëtorëve dhe mekanizmit dhe pajisjes tjetër teknike që posedon, ose që do të plotësojë në mënyrë që të jetë efikas dhe të kryejë këtë punë në kohë sa më të shpejtë dhe me rezultate të kënaqshme;
- Bënë sanimin në çdo kohë dhe në çdo vend në Zonën e shërbimeve të gjitha defekteve , avarive dhe pengesave tjera që paraqiten, sa më shpejtë dhe sa më me pak shpenzime duke u mbështetur në radhë të parë në mjetet e KRU-së dhe materialin e potencialin të cilin e disponojmë.

Gjat muajit **SHTATOR / 2020** kemi pas gjithsej **392** intervenime te parqitura ne formë tabelare duke krahasuar me muajin e njejt të vitit te kaluar dhe ate sipas sherbimeve :

Muaji/Sherbimi	1.Rrjeti I ujit	2.Sh.Ujëmatës.	3.Sh.Makinerisë	4.Sh.Elektros	Total/Muaj
Shtator/2019	190	52	38	45	325
Shtator/2020	204	67	58	63	392



Grafiku i intervenimeve ne krahasim me periudhën e njëjtë te vitit paraprak

• Shërbimi i rrjetit të Ujit

Gjat muajit Gusht ne rrjetin e ujit kemi pas gjithsej **204** raste te intervenimeve te paraqitura ne formë tabelare:

Nr.	Rruga /Lokacioni I intervenimit/	Profili(Ø)	Materili	Vërejtje
1	Fushe Kosove	400	PE	1 rast
2	Hajvali (Pallati I Drejtësisë), Kroni	250	PE, AC	2 rast
3	Rruget (A.Ramadani, M.Fejza, Llapit, Kalabri)	20-225	AC, PE	10 raste
4	Llukar, F.Kosovë, Grabovc, Vranidoll, Rr. B.Bahtiri	150-160	PE, AC, PVC	11 raste
5	Rr. G.Zajmi, F.Kosovë, B.i Madh, Sh.Robaj, B.i vogel	100-125	PE, PVC, AC	13 raste
6	Prugovc, Rr.UÇK-se, Rr.Shkupit, Rr.F.Curri, Dardani	75-90	PE, PVC, Zn	25 raste
7	Te ndryshme	(1/2-6/4)	PVC, PE, Zn	mbi 140 raste

Paraqitja ne formë tabelare

Ekipet e Mirëmbajtjes kanë ber shtrirjen e Gypit 1” ne gjatësi pre 100 m për konsumatorët te cilët kanë mbet pa ujë me rastin e eliminimit te gypit i cili ka qen i kyqur ne lëshuesin e gypit te çelikut te “Kodrina”

- **Shërbimi i Ujëmatësve**

Gjat muajit Gusht ky shërbim ka intervenuar ne 63 raste te paraqitura përmes Departamentit te Konsumatorëve si dhe DSH .

UM-DN/ Konsumatori	shtëpiak	kolektiv	komercial	onstitucional	Totali
1	15	16	5		21
2	20	33	4		37
3	25	2			2
4	40	4	1		5
5	50	2			2
Totali	51	6	10	0	67

Paraqitja tabelare sipas profileve /konsumatorëve/

Është intervenuar ne riparimin e ujëmatësve të ndryshëm, ndërrimin e valvuleve para dhe pas ujëmatësve, pastrim i xhamit te ujëmatësit, deblokimi i bllokadave etj .

- **Shërbimi i Makinerisë**

Shërbimi i Makinerisë përveç rasteve te kontroleve sistematike te pajisjeve ne Objektet e FPU- Batllavë, Badovc, Kroni, Objektet –Stacionet e Pompimeve dhe NJOU ka intervenuar ne **58** raste, lidhur me problemet e makinerisë.

- Rregullimi i sistemit e klorit në F.P.U. në Badovc.
- Punë në stacionin e pompave shtytëse në Breg të Diellit.
- Rregullimi e pompave në objektin Parku
- Evitimi e një rrjedhje në gyp të çelikut afër rezervuarit të ujit në Arbëri
- Montimi dhe demontimin e dy pompave në dy puse të ujit në Peran.
- Rregullimin e njërës valvulë të presionit në njërën pusetë në fshatin Shakovicë.
- Rregullimi i njërës pompë në stacionin e pompave në Besi
- Rregullimi i njërës pompë të sistemit të klorit në objektin Kroni.
- Aftësimi i pompave në Besi.
- Asistimi dhe rregullimin e pompës në defekt të objektit Mirdita III.

- **Shërbimi i Elektrikes**

Ky shërbim përveç rasteve te punëve kontrolluese te sistemeve dhe pajisjeve elektrike ne Stacionet e Pompimeve si dhe Fabrikave ka intervenuar edhe ne aftësimin e sistemeve ne NJOU.

Gjat muajit Shtator kanë intervenuar Gjithsej ne **63** raste, si :

- Aftësimi i HP ne “Bregun e Diellit”
- Rregullimi i elektromotorëve ne stacionin e pompimit ne Shtime
- Rregullimi i prizave ne SP ne Park
- Sanimi i kabllos eklektikë ne “Mirditë-3”
- Aftësimi i Frekventorve ne Shkabaj
- Rregullimi i automatikës ne Dobrevë
- Punimi i Ormanit Elektrik ne S.P. Mirditë
- Sanimi i kabllos 4*16 mm ne Dragodan
- Demontimi dhe montimi i pompave ne Peran
- Ndrimi i sondave SP ne Bregun e Diellit

- **Objektet ne qytet**

Objektet ne qytet kanë punuar ne distribuimin e ujit ne vartësi nga prurjet e FPU “Batllava, “Badovci” dhe “Shkabaj”

Gjate muajit Shtator, objektet ne qytet kane punuar mire pa probleme te theksuara ne distribuimin e ujit ne rrjetë

- **Shërbimi i Dispeçerisë**

Ky shërbim është ne dispozicion 24/ 7 ditë ne javë i cili e benë harmonizimin e punëve për funksionimin normal dhe kontiunal të tërë sistemit në stacionet e pompimit, FPU dhe në puse te KRU-së.

Ende ky shërbim ka mbet pa u plotësuar me një punëtor për mbulese te pushimeve vjetore dhe mungesës ne pune.

15. DEPARTAMENTI I MIRËMBAJTJES DHE TRAJTIMIN E UJËRAVE TE NDOTURA

Qëllimi i Departamentit është organizimi dhe funksionimi i tij për mirëmbajtjen e sistemit te kanalizimit dhe trajtimin e ujerave te zeza duke u bazuar dhe plotësuar standardet sipas udhëzimit administrativ.

Departamenti i Mirëmbajtjes dhe Trajtimin e Ujërave të Ndotura është i përbërë nga:

Shërbimit i Mirëmbajtjes të Rrjetit të Kanalizimit, ku bënë mirëmbajtjen e sistemeve të kanalizimit në KRU “PRISHTINA” sh.a, në të gjithë zonën e shërbimit qe përfshin 8 komuna, me gjatësi të rrjetit të kanalizimit **1093km**. Angazhimin e gjithë potencialit të vet, ekspertëve, punëtorëve, mekanizmit dhe pajisjeve teknike që posedon, që të kryejë punët në kohë dhe me rezultate të kënaqshme.

Bënë pastrimin, deblokimin dhe sanimin në çdo kohë dhe në çdo vend në Zonën e shërbimit të gjitha defekteve, bllokimeve dhe pengesave tjera që paraqiten ne kolektor te kanalizimit te ujerave te ndotura urbane (me kontratën per sanimin e gypave me kontraktorin Cahanin).

Shërbimi i Trajtimit të Ujerave të Ndotura

Momentalisht janë dy Impiante te Trajtimit te Ujërave te Ndotura në funksion.

1 Impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura në Halilaq nën zonën kadastrale F.Kosovës

2 Impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura në Mramor – Badoc nën zonën kadastrale Prishtinë

Trajtimi e ujerave te zeza behet duke u bazuar ne udhëzimin administrativ MMPH – Nr.30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese te shkarkimit të ujerave të ndotura ne rrjetin e kanalizimit publik dhe ne trupin uhor. Ky udhëzim përcakton kriteret e përgjithshme për shkarkimin e ujerave te ndotura, cakton parametrat fiziko-kimike dhe atyre bakteriologjik.

Aktivitetet apo përshkrimi i shkurtër i punëve të kryera brenda muajit;


Gjatë muajit **Shtator 2020** kemi pas gjithsej **417** intervenime te rasteve ne de bllokim te kanalizimin, pastrim te puseta 38 puseta dhe vendosje te kapakëve te puseta 9 kapak ne gjithë zonën e shërbimit te KRUP

Shtator 2020	Rastet e paraqitura	Rastet e kryera
Java e I	75	75
Java e II	65	65
Java e III	97	97
Java e IV	85	85
Java e V	91	91
Gjithsejtë	413	413

Krahasimi i rasteve te kryera me vitin paraprak :

Viti	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2019	320	289	394	395	420	461	500	414	385	409	235	362
2020	366	356	336	332	333	456	373	417	413			

Tabela krahasuese e rasteve 2019/2020



Paraqitja e rasteve te pastrimit te pusetave:

Qershor	Pastrim të pusetave	Vendosja e kapakut beton/metal
Java I/IV	51puseta	2/1
Gjithsej	51 puseta	3 kapak

Sipas rregullores nr.10/2019 për standardet minimale të shërbimeve të ujit në Kosovë: i tërë rrjeti i kanalizimit duhet të pastrohet së paku një herë në pesë (5) vjet, dhe të gjitha pusetat e kanalizimit duhet të inspektohen së paku një herë në dy (2) vjet dhe duhet të bëhet pastrimi i tyre varësisht prej nevojës.

Planifikimi vjetor për pastrim te rrjetit te kanalizimit ne metra gjatësi

Viti 2020	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Planifikimi m'	20000	20000	20000	20000	20000	20000	20000	20000	20000	20000	20000	20000
Realizimi m'	18300	21360	20160	19920	19980	21050	20200	19500	20040			

Planifikimi vjetor për pastrim te pusetave te kanalizimit (ne numër).

Viti 2020	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Planifikimi copë	20	20	30	30	30	30	20	20	30	30	20	20
Realizimi copë	32	27	32	43	31	38	42	38	51			

Përveç punëve ne de bllokime te sistemit te kanalizimit dhe pastrimit te pusetave ne muajin Shtator është për tu cekur:

- Sanimet në vazhdim nga kompania kontraktuese për gypat e dëmtuar komplet ne zonën e shërbimit.

Punët e planifikuara dhe shkalla e realizimit të tyre: Planifikimet për pastrim dhe shpëlarje të kolektorëve për këtë muaj është arritur, te gjitha rastet e bllokimeve te paraqitura janë kryer sipas kërkesave.

16. DEPARTAMENTI I HUMBJEVE

Departamenti për Reduktimin e Humbjeve në vete përmban dy shërbime:

- **Shërbimi e inspektimit dhe shkyçjes**
- **Shërbimi për detektimin e rrjedhjeve**

Përshkrimi i punëve të kryera brenda muajit raportues

Duke u bazuar në sasinë e prodhimit dhe faturimit shkalla e humbjeve të ujit për muajin Shtator kanë arritur shkallën 58.1%

Prodhimi.....4,547,585 m³

Faturimi.....1,901,136 m³

Humbjet 2,646,449 m³

Humbjet (e autorizuar) 10,663m³ gjatë shpërlarjes së gypave magjistrat

UPF(%)=58.19

Dallimi nga muaji Gusht në muajin Shtator kemi një ulje prej **1.2%** të ujit pa të ardhura(NRW) ndërsa prodhimi është rritur për **59,373m³**

Shkaqet e humbjeve kaq të larta sipas analizave të Departamentit:

- Faturimet minimale mujore ndikojnë në mos rritjen e shkallës së faturimit.
- Keqpërdorimet e ujit, rrjedhja në gypa, mosfunksionimi i ujëmatësve mos lejm i qasjes në ujëmatës.
- Leximit janë të vështirësuar edhe për shkaqe të Pandemisë në të cilën po kalojmë nga marsi e deri tani e që është edhe një fenomen shtesë i cili po ndikon negativisht tek lexuesit.
- Raportimi nga lexuesit për numër të madhe të ujëmatësve që vazhdojnë të jenë jashtë funksionit
- Faturimi vetëm me tarifë fikse për konsumatorët që nuk kanë të instaluar ujëmatës individual sipas rregullores së ARRU-së vazhdon të jetë një sfidë në vete dhe në dëm të kompanisë.
- Rritja e kohës deri në riparimin e rrjedhjes(mungesë e personelit të operativës)

- **Shërbimi e inspektimit dhe shkyçjes**

Sa i përket shërbimit të inspektimit dhe shkyçjes në muajin 09/2020 ka pasur 11 lajmërimi të rrjedhjeve të ujit në zyrën e informacioneve. Janë krye 1.809 vizita për pagesa dhe si rezultat i vizitave janë inkasur 80.713,39 €. Janë ekzekutue 14 shkyqje dhe 18 rikyqje, janë zbulue 13 kyqje ilegale janë ekzekutue 13 shkyqje ilegale, . Janë rikyq 1 klient pas aplikimi për legalizim, 20 klient kanë bërë riprogramimin e borgjit, dhe janë regjistruar 18 klient të ri.

17. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT

Ky raport mbulon muajin shtator të këtij vit dhe jep informacione rreth gjendjes së aktiviteteve të dorëzuara dhe atyre të padorëzuara të prokurimit.

Raporti jep të dhëna të detajuara edhe për gjendjen e Investimeve Kapitale, për periudhën janar-shtator të këtij viti, përfshirë edhe disa të dhëna rreth aktiviteteve jasht planit të prokurimit si dhe të kontratave të nënshkruara.

Në tabelat e bashkëngjitura jipen të dhënat për periudhën raportuese, si vijon:

- Aktivitetet e planifikuara për muajin shtator dhe gjendja e tyre;
- Investimet Kapitale deri në muajin shtator dhe gjendja e tyre;
- Aktivitetet jasht planit të prokurimit gjatë muajit shtator dhe gjendja e tyre; dhe
- Numri dhe vlera e kontratave të nënshkruara gjatë muajit shtator

PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE

-Aktivitetet e planifikuara për muajin shtator dhe gjendja e tyre

Gjatë muajit shtator kanë qenë të planifikuara për inicim tre/3 aktivitete, në vlerë të parashikuar prej 154,000.00 €. Deri në datën e raportimit (01.10.2020), është inicuar vetëm aktiviteti për Furnizim me Naftë dhe Benzine, ndërsa dy aktivitete të tjera nuk janë inicuar ende. *Detajet janë dhënë në tabelën 1.*

-Investimet Kapitale deri në muajin shtator dhe gjendja e tyre

Deri në muajin shtator, në emër të Investimeve Kapitale, kanë qenë të planifikuara të inicohen 21 aktivitete të prokurimit, në vlerë të parashikuar prej 1,312,400.00 €. Deri në datën e raportimit (01.10.2020) janë inicuar gjithsej tetë/8 aktivitete, në vlerë të parashikuar prej 545,850.00 € (41.59 %). Nga aktiviteti me numer rendor 21 (shiko tabelën 2) mund të vërehet se vetëm pjesa prej 31,850.00 € është inicuar si bashk-financim me komunën e Lipjanit. Pjesa e Investimeve Kapitale në vlerë të parashikuar prej 766,550.00 € (58.41 %), ku ben pjesë edhe vlera e mbetur e bashkfinancimeve nga aktiviteti nr.21, në vlerë prej 128,150.00 €, ende nuk janë inicuar. *Detajet janë dhënë në tabelën 2.*

-Aktivitetet jasht planit të prokurimit gjatë muajit shtator dhe gjendja e tyre

Gjatë muajit shtator nuk kemi evidentuar kërkesa jasht planit të Prokurimit.

Siç është raportuar edhe në raportin e muajit gusht, gjatë muajit shtator kemi në proces projektin e aprovuar në Parlamentin e Republikës së Kosovës, përmes Ligjit nr. 05/L-154), i cili ka të bëjë me marrëveshjen e Republikës së Kosovës dhe asaj të Francës, për Ndërtimin e Infrastrukturës për Trajtimin e Ujërave të Zeza. Aktualisht është publikuar faza e parë e "Parakualifikimit", e cila do pasohet me fazën tjetër që është faza e përzgjedhjes së Konsulentit, i cili pastaj do projektoj dhe mbikqyrë projektin në tërësi. Vlera e parashikuar e kontratës për Shërbime Konsulente është 3,500,000.00 €.

-Numri dhe vlera e kontratave të nënshkruara gjatë muajit shtator

Gjatë këtij muaji kemi nënshkruar vetëm një kontratë për vendosjen e xhamave në sportele, në vlerë prej 325.00 €.

Tabela 1. Aktivitetet e planifikuara për muajin shtator dhe gjendja e tyre

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	Vlera e parashikuar(€)	Periudha e parapare	Gjendja
1	Hardver për TI (kompjuterë të tavolinës, llap top, monitor, smart phone dhe printer mobil etj)_KK 2	20,000.00	04.09.2020	E painicuar
2	Furnizim me Lende Djegese_Nafte & Benzine Dimerore	74,000.00	11.09.2020	Ne proces
3	Rehabilitimi i objekteve(makinerik dhe elektrik i objekteve të KRU Prishtina sh.a. Zallimi ne Galerit e gypave, ngjyrosje e gypave , ngjyrosje dyerve metalike ne objekte prodhuese, ndriqimin ne objekte prodhuese dhe rezervoar)	60,000.00	04.09.2020	E painicuar
Gjithsejt		154,000.00		
Shprehja ne %		Sipas numrit	%	Sipas vlerave (€)
				%
Aktivitete të planifikuara		3	100.00%	154,000.00
Aktivitete të inicuar		1	33.33%	74,000.00
Aktivitete të painicuara		2	66.67%	80,000.00

Tabela 2. Investimet Kapitale deri në muajin gusht dhe gjendja e tyre

Nr	Përshkrimi i aktivitetit	Periudha e parapare	Vlera e Parashikuar (€)	Gjendja
1	Ndërrimi dhe ndërtimi i rrjetit të ujit për përmirësimin e furnizimit dhe zvogëlimin e humbjeve në zonën e shërbimit të KUR "Prishtina" (Prishtinë, Lipjan, Podujevë, Obiliq, Shtime, Fushë Kosovë, Gracanice dhe Drenas)	Mars	200,000	E perfunduar
2	Furnizimi me ujëmatës të profileve të ndryshme për ndërrim të vazhdueshëm të ujëmatësve që nuk funksionojnë në pajtim me rregullativën e parapërcaktuar (montimi nga personeli i KRUP)	Janar	35,000	E perfunduar
3	Furnizimi me pllomba per pllombimin e ujematesve ne vazhdimesi	Janar	10,000	E perfunduar
4	Furnizimi dhe montimi me ujëmatës të profileve Fi 1/2 deri 2" për ndërrimin e ujëmatësve ekzistues në pajtim me rregullat e parapërcaktuara, në zonën e shërbimit.	Qershor	70,000	E painicuar
5	Furnizimi dhe instalimi i ujëmatësve zonal në zonën e shërbimit të KUR "Prishtina" sh.a. (perfshire pusetat)	Prill	45,000	Ne pritje te te dhenave teknine
6	Furnizimi dhe montimi i elektomotorit dhe pompës Stacionin e pompimit në Batllavë dhe Badovc	Shkurt	150,000	E perfunduar
7	Rehabilitimi dhe Ndërtimi I sistemit te klorimit të lengët dhe te gazët në objektet përcjellëse në KUR "Prishtina" sh.a. Mbrojtja e burimeve ujore FURNIZIM.	Korrik	20,000	E painicuar
8	Furnizimi me pompa centrifugale horizontale dhe vertikale si dhe pompave zhytëse përfshirë edhe paisje (frekuentor) në stacionet e nxjerrjes dhe shtytjes.	Korrik	20,000	E painicuar
9	Rehabilitimi ndertimor - arkitektonik i objekteve ne KURP	Mars	44,000	E painicuar
10	Furnizimi me inventar (mobilje për zyre, rafta etj)	Shkurt	20,000	Nuk inicohet, kemi kontrate deri me 2021
11	Furnizim, motim dhe mirëmbajtje e GPS	Janar	15,000	Ne proces
12	Hardver për TI (kompjuterë të tavolinës, llap top, monitor, smart phone dhe printer mobil etj)	Janar	20,000	E painicuar

Nr	Përshkrimi i aktivitetit	Periudha e parapare	Vlera e Parashikuar (€)	Gjendja
13	Mirëmbajtja dhe zhvillimi i moduleve eksistuese: Faturimi, Mobile of line, LAN dhe BEKAP i shënimeve	Mars	25,000	E painicuar
14	Mirëmbajtja vjetore për NAVISION (programi i kontabilitetit dhe financave)	Janar	29,000	Ne proces
15	Dixhitalizimi i arkives qendrore	Gusht	40,000	E painicuar
16	Ndërtimi dhe riparimi i pusetave të ujësllësit dhe kanalizimit _kontrata ne proces	Shkurt	10,500	Nuk inicohet, kemi kontrate deri me 2021
17	Rehabilitimi dhe ndertimi I rrjetit te kanalizimit	Mars	30,000	Ne proces
18	Furnizimi me cisterna speciale (autobote) për ujë dhe ujëra të zeza për kryerjen e shërbimeve në zonën e KRUP	Shtator	230,000	E painicuar
19	Ndërtimi i objektit tekniko administrativ në Njësitë operative sipas modelit "çelësat në dorë" (Graqanicë dhe Fushë Kosovë) varësisht nga gatishmëria e pushtetit local për ndarje të parcelës dhe lejeve ndërtimore	Shtator	80,000	E painicuar
20	Furnizimi me eskavator (skip) për mirëmbajtjen e rjetit të ujësllësit dhe ujërave të ndotura (kapaciteteve të ndryshme)	Shtator	58,900	E painicuar
21	<u>Projekte të ndryshem të bashkëfinancimit me komunitetin, donatorët. Fokusimi në zgjerimin e rrjetit, zëvendësimi i rrjetave të amortizuara dhe mirëmbajtje dhe operim të të njëjtave (rrjeti i ujit dhe ujërave të ndotura)(31850 € bashkefinancim me KK Lipjan-aktivitetet e prokurmit udhehiqen nga komuna)</u>	<u>E koordinuar me komunitetin</u>	<u>160,000</u>	<u>Nga 160,000.00 €, vetem 31,850.00 € te inicuara me KK Lipjan</u>
Gjithsejt			1,312,400.00	
Shprehja ne %		Sipas numrit	Vlerat financiare (€)	%
Investime Kapitale të planifikuara		21	1,312,400.00	100
Investime Kapitale të inicuara		9	545,850.00	41.59
Investime Kapitale të painicuara		12	766,550.00	58.41